



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

Korçë, më 22.12.2021

VENDIM

Nr. 23 datë 22/12/2021

“PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR”

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në nenin 5 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.429, datë 12.09.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Kryesia, Këshilli i Qarkut Korçë,

VENDOSI:

1. Ti propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shtesës të pensionit të posaçëm shtetëror:
 - Anastas Gjergji Kostandini, lindur në Pogradec më 23.07.1954
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik e shërbimeve.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ANA VERUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

Për Përfitimin e pensionit të posaçëm shtetëror

Për Z. Anastas Kostandini

Në mbledhjen e Këshillit të Qarkut Korçë në datën 22.12.2021, është paraqitur nga ana e kryetarit të Bashkisë Pogradec edhe propozimi për të propozuar Këshillit të Ministrave caktimin e një shtese pensioni të posaçëm shtetëror mbi pensionin që i takon nga sigurimet shoqërore, z. Anastas Gjergji Kostandini.

Nga dokumentacioni rezulton se personi i propozuar i përmbush kriteret ligjore të përcaktuara në VKM Nr. 429, Date 12.9.2002 “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore” që Këshilli i Qarkut Korçë ti propozojë Këshillit të Ministrave caktimin e një pensioni të posaçëm shtetëror.

I lindur në Pogradec më 23.07.1954, z. Anastas Kostandini diplomohet për Pikturë Monumentale në vitin 1978 dhe në vitin 1983 hap ekspozitën e parë personale në Tiranë, e cila pasohet nga një sërë ekspozitash të hapura ku paraqitet qarte volumi i krijimtarisë së piktorit të mirënjohur.

Gjatë karrierës së tij të gjatë ai është vlerësuar me një sërë titujsh, ndër të cilët mund të përmendim:

- Çmimin e tretë në 40- vjetorin e Çlirimit të Atdheut për kompozimin në pikturë të “Borova martire”, Tiranë.
- Urdhërin “Naim Frashëri” të klasit II nga Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë në 07.05.1983 Tiranë.
- Titullin “Piktor i Merituar” nga Presidenti i Republikës në 05.08.1991 Tiranë.
- Titullin “Qytetar Nder” nga Këshilli i Bashkisë Pogradec, në vitin 2005.

Z. Anastas Kostandini i përmbush parashikimet e nenit 5 pika b të ligjit 7703 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Kërkesa përmban gjeneralitetet, e kërkesit dhe është e shoqëruar me dokumentat, si vijojnë:

- Fotokopjen e letërnjoftimit elektronik dhe certifikatën e gjendjes civile;
- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore për masën e pensionit;

- Kopjet e noterizuara të dokumentave që vërtetojnë meritat e veçanta si: titujt, medaljet, urdhërat etj;

Dokumentacioni i paraqitur është konform VKM Nr.429, datë 12.09.2002 "Per kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posacme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posacme shtetërore".

KRYETARI I KËSHILLIT TË QARKUT

ANAVERËSHTI

